

0300-43

1/15



# AKTIVITETET PROJEKTUESE ARTI MUZIKOR

Shkup, 2004

## KORR DHE ORKESTËR

### QËLLIMI

Qëllimi i aktiviteteve projektuese nga arti muzikor KORRI dhe ORKESTRI është që nxënësit t'i zgjerojnë njohuritë nga arti muzikor dhe kultura për të cilat tregojnë interes të posaçëm, përcaktim dhe senzibilitet. Nxënësit të aftësohen individualisht dhe kolektivisht në prezantim të përbashkët të veprave vokalo-instrumentale në shkollë dhe jashtë saj.

### Qëllimet e veçanta

- të krijojë shprehje për rregullshmëri dhe precizitet;
- të zhvillohen aftësitë krijuese, vlerat etike dhe estetike;
- të zhvillojë marrëdhënie kolektive intelektuale-emocionale dhe marrëdhënie kah interpretimi i kompozimeve të korrit ose orkestrit;
- të zhvillojë aftësi për interpretim instrumental individual dhe interpretim vokal;
- t'i respektojë udhëzimet e dhëna dirigjentit-mentorit;
- t'i zgjerojë njohuritë teorike në lëmin e historisë së muzikës dhe kritikën letrare;
- t'i vlerësojë vlerat e veprave muzikore përmes analizës;
- të zbulojë mundësi të reja për zbatim të aktivitetit në korr/orkestër dhe në projektet e sintetizuara ose në projektet multimediale;
- t'i zgjerojë njohuritë për rolin e muzikës dhe arteve tjera dhe lidhshmëria e tyre mes veti;
- të marr pjesë në shfaqje të ndryshme (në shkollë, në mjedisin lokal etj);
- të bashkëpunojë me persona tjerë nga kultura, institucionet, organizata profesionale nga lëmi i artit dhe kulturës;
- të ketë dëshirë për interpretim vokal, instrumental-vokale dhe njohja e kulturës të popujt tjerë;

### NEVOJITEN DITURI PARAPRAKE

Për të arritur qëllimet e aktiviteteve të artit muzikor KORR/ORKESTËR nxënësi duhet t'i shfrytëzojë njohuritë paraprake të fituara në arsimin fillor dhe përvoja e fituar në manifestime të ndryshme muzikore.

## PROCESI ARSIMOR

Struktura e përmbajtjeve për aktivitetet

| PJESA PËR PËRPUNIM | Qëllimet konkrete | Kahjet didaktike | Korelacione me lëndët tjera | Koha e realizimit |
|--------------------|-------------------|------------------|-----------------------------|-------------------|
| Audicioni          | Nxënësi:          | Arsimtari:       |                             |                   |
| 1.                 |                   |                  |                             |                   |
| 2.                 |                   |                  |                             |                   |
| 3.                 |                   |                  |                             |                   |
| 4.                 |                   |                  |                             |                   |
| 5.                 |                   |                  |                             |                   |

## Organizimi i aktiviteteve projektuese:

Aktivitetet projektuese nga arti muzikor KORR/ORKESTËR do të organizohen në grupe të përbëra prej 35 nxënësve- minimum, kurse maksimumi mvaret nga aftësitë dhe interesimi i nxënësve. Grupet mund të përbëhen prej nxënësve të vitit të I,II,III, dhe IV sipas interesimit dhe mundësive të nxënësve. Koha e realizimit do të jetë jashtë orarit të rregullt të mësimit, dmth gjatë kohës së lirë. Për arsye të specifikës së aktiviteteve koha e realizimit do të organizohet sipas lokaleve të lira në shkollë dhe mundësive të nxënësve. Rezultatet do të prezentohen në aktivitetet e shkollës dhe garat e Korrit që realizohen çdo vit shkollor, në mjedisin lokal dhe më gjërë për manifestime të ndryshme.

## Lëndë mësimore dhe aktivitete në të mësuarit dhe krijimtari

Në realizimin e qëllimeve të aktiviteteve projektuese KORR/ORKESTËR do të zbatohen metoda dhe forma mësimore: hulumtuese, problematike, frontale, grupore, individuale etj. Në punë do të dominojë iniciativa, pavarësia, kreativiteti, shprehja e lirë përmes prezentimit vokal dhe instrumental. Do të bashkëpunohet me institucione të ndryshme kulturore-artistike, shkolla të muzikës, artistë tanë të njohur, kompozitorë, solo-këngëtarë, instrumentalistë, lojtarë të baletit, dhe të gjithë ata që do të ndihmojnë në arritjen e qëllimeve të parashtruara për këto aktivitete.

## Kushtet hapsinore dhe tekniko-materiale

Mësimi do të realizohet në kabinetet adekuate të artit muzikor të pajisur me mjete adekuate, instrumente dhe literaturë adekuate. Do të shfrytëzohen materiale disponuese dhe mjete teknike dhe kuptohet me instrumentet që i posedon nxënësi.

Debutim: Manifestime në korr/orkestër

Aktivitete në shkollë

Aktivitete në mjedisin lokal

# AKTIVITETE NGA LËMI I MUZIKËS

## REALIZIMI I LËMIVE TË MUNDSHME TË REJA

- \* ADHURUES TË MUZIKËS
- \* KLUB MUZIKORO-GAZETARESK
- \* KLUB FOLKLORIK
- \* KOMPOZITORË TË RINJË-HULUMTUES

### QËLLIMET E PËRGJITHSHME

- mësimi i nxënësve në punën hulumtuese (të gjitha fazat nga planifikimi deri te prezentimi i shfaqjes nga hulumtimi);
- aftësimi i nxënësve për pavarësi në punë;
- nxitja e nxënësve për bashkëpunim në ekip gjatë hulumtimit dhe gjetja e mundësiye tjera për bashkëpunim jashta shkollës (vizitë operës, baletit, filharmonisë, institutit për folklor, koncerte të muzikës serioze, argëtuese, popullore dhe llojeve tjera);
- aftësimi i nxënësve për evidencën, selektimin, analizën e informacioneve, shuma valide e rezultateve dhe hartimi burimor i rrëfimit të hulumtimit;
- aftësimi i nxënësve për prezentim kompetent dhe të pavarur të detyrës së kryer;
- përkrahja e nxënësve për përmbushjen e projektit që duhet të realizohet;
- përkrahje nga institucionet tjera për përmbushjen e detyrave të parashtruara, të cilat duhet realizuar;
- nxitja e interesit dhe dashurisë ndaj muzikës.

### QËLLIMET E VEÇANTA

- \* zbulimi i interesimit të nxënësit për lëmi të caktuara nga sfera e muzikës;
- \* trajnimi i nxënësve për përpunimin e projektit nga sfera e muzikës;
- \* zgjerimi dhe thellimi i njohurive të nxënësit në sferën e muzikës;
- \* nxitje e marëdhënies individuale të nxënësit në problemin muzikor dhe në muzikën në tërësi;
- \* nxitje e bashkëpunimit në grupe (punë ekipore);
- \* zbulimi i kreativitetit të nxënësi;
- \* të zhvillojë aftësi krijuese, vlerat etike dhe estetike;
- \* të planifikojë, organizojë dhe realizojë pjesëmarrje në manifestime të ndryshme (në shkollë, në mjedisin lokal etj);
- \*

- \* të bashkëpunojë me individë tjerë të institucioneve, organizatave profesionale nga sfera e artit dhe kulturës;
- \* të zhvillojë dëshirë në interpretimin vokal, instrumentalo-vokal dhe instrumental;
- \* mirënjohja e traditave kulturore të popujt e ndryshëm dhe tradita e tyre muzikoro-folklorike ;
- \* të zhvillojë dëshirë për prezantim individual për hartimin e aktiviteteve projektuese;

## KAHJE TË PËRGJITHSHME PËR PLANIFIKIMIN E AKTIVITETEVE

Aktivitetet planifikohen dhe realizohen në kuadër të orëve të fondit vjetor. Planifikimi i aktiviteteve projektuese duhet të jetë fleksibil dhe i përshtatshëm në aftësitë individuale të nxënësit, mjediseve kulturore dhe kushteve shkollorë. Fondi vjetor i orëve përfshihet me 35 orë që do të realizohen në këtë mënyrë:

- 15 orë të cilat arsimtari i shfrytëzon për të dhënë krahje të përgjithshme dhe sqarim të qëllimit, metodologjisë (shfrytëzimi i datotekave të ndryshme, literaturës profesionale dhe burime tjera të të dhënave, psh. përcjellja e e veprës muzikoro-skenike, përshkruarja e veprës përmes video prezantimit ose sipas mundësive në TPM), përpilimi i planit punues, analiza e të dhënave, përpunimi i shfaqjes së hulumtimit, instrumenteve për përpunimin e detyrave projektuese dhe mënyra e prezantimit;
- 20 orë nxënësi i realizon në mënyrë të pavarur, por vazhdimisht është nën kujdesin e arsimtarit-mentorit. Nxënësi udhëheq dosien-portfolion e tij në të cilën i shënon aktivitetet e veta. Nxënësi ka mundësi t'i zbulojë krijimet e veta individuale dhe aftësitë kreative. Ka mundësi të zbulohet nxënës talentë dhe me të të orientohet arsimimi i mëtutjeshëm. Nxënësi punon në punë të pavarur hulumtuese. Komunikimi arsimtar-nxënës është komunikim i ri (mentor) ku fitohen respekti dhe vetbesimi dhe me këtë përforcohet marrëdhënia nxënës-arsimtar.

# ADHURUES TË MUZIKËS

## Qëllimi i përgjithshëm

Të zhvillojë dashuri dhe ineresim në llojet e ndryshme të muzikës përmes hulumtimit, analizës, zbulimit të njohurive të reja dhe arritja në botën e muzikës. Nxitja e nxënësve për interpretim individual, grupor, vokal ose instrumental, bashkëpunim në ekip dhe gjetja e mundësive tjera për bashkëpunim jashtë shkollës (vizitë operës, baletit, filharmonisë shqiptare, institutit për folklor, koncerte të muzikës serioze, argëtuese, popullore dhe llojeve tjera të muzikës);

## Qëllimet konkrete

- trajnimi i nxënësit për përpunimin e projektit muzikor;
- zbulimi i aftësive për interpretim vokalo-individual;
- zbulimi i aftësive për interpretim instrumental dhe përkrahje ekipore në grupe;
- zgjerimi dhe thellimi i njohurive nga sfera e muzikës (lloje të ndryshme të muzikës) të dëshirës të hulumtimit grupor;
- bashkëpunim kreativ me institucione të ndryshme që mundësojnë informim më të madh për hulumtim në sferën e muzikës;
- aftësimi i nxënësve për evidentimin, selektimin, analizimin e informatave;
- aftësimi i nxënësve për prezantim kompetent dhe të pavarur të detyrës së kryer;
- përkrahje nga shkolla për përmbushjen e projektit i cili duhet të realizohet;

|    | LËMIA              | TEMA   |
|----|--------------------|--|
| I. | HISTORIA E MUZIKËS | Origjina e muzikës dhe zhvillimi i saj   |
|    |                    | Muzika në Romën e vjetër   |
|    |                    | Muzika në mesjetë  |
|    |                    | Muzika botërore mesjetare  |
|    |                    | format muzikore në renesansë   |
|    |                    | Paraqitja e operës   |
|    |                    | Instrumentet e barokut   |
|    |                    | Dallimi mes Hajdn dhe Mocartit   |
|    |                    | Vizita në tribuna profesionale të organizuara në "Muzika vjeshtore Strugane"                         |
|    |                    | Vizita në ligjërime profesionale në FAM nga kompozitori jonë vendas për veprimtarinë e tij krijuese. |
|    |                    | Vizita dhe analiza e operës: "Travijata" (Analiza e libreto)   |
|    |                    | Vizitë dhe analiza e baletit: "Liqeni Lebedovo" ( )  |

|    |                              |   |
|----|------------------------------|---|
| 2. | FOLKLORI                     | Karakteristikat themelore të folklorit muzikor<br>Metrika, ritmi dhe melodia e këngës popullore |
|    |                              | Instrumentet popullore muzikore   |
|    |                              | Vallja- tradita popullore   |
|    |                              | Folklori shqiptar në stilet moderne   |
| 3. | INTERPRETIMI<br>VOKAL        | Kompozimi argëtues''  |
|    |                              | Kënga popullore''   |
|    |                              | Bisedë me interpretues vokal të njohur të këngëve argëtuese                                     |
|    |                              | Bisedë me interpretues vokal të këngëve popullore   |
|    |                              | Parapërgatitje për manifestim- koncert  |
| 4. | INTERPRETIMI<br>INSTRUMENTAL | Kompozim argëtues''   |
|    |                              | Kompozim sipas dëshirës së nxënësit   |
|    |                              | Bisedë me interpretues instrumental të njohur nga vendi jonë                                    |
| 5. | MUZIKA<br>ARGËTUESE          | Vizita në koncert''   |
|    |                              | Intervistë me kompozitor-krijues të këngëve argëtuese   |
| 6. | MUZIKA<br>POPULLORE          | Vizita në SHKA  |
|    |                              | Vizita në koncerte të këngëve popullore   |
|    |                              | Vizita në parapërgatitje të SHKA  |
|    |                              | Bisedë me krijues të njohur të instrumenteve popullore  |
|    |                              | Vizita në institucion për folklor muzikor ''Marko Cepenkov''                                    |

#### ORGANIZIMI I KOHËS

Arsimtari organizon dhe realizon ''udhëheqje'' paralele të më shumë projekteve hulumtuese nga tema e njejtë në të cilat janë përfshirë grupe punuese të nxënësve të moshës së njejtë (viti i I ose i II). Lëmi që duhet të jenë të organizuara si psh. vizitë në koncert, operë ose balet atëherë koha planifikohet dhe organizohet sipas kohës së paraparë në institucionin e caktuar. Për të vizituar këtë lloj të aktiviteteve mund të marrin pjesë nxënës të cilët tani më kanë treguar interesim për këtë lëmi prej vitit të I, II, III, IV. Gjithashtu, aty ku nxënësit në mënyrë individuale duhet ta prezantojnë aktivitetin e tyre, arsimtari së bashku me nxënësin e planifikon kohën për konsultime dhe rekomandime, për problemet e dhëna për interpretim vokal ose instrumental. Çdo nxënës është i detyruar të hartojë mendim (në formë të shkruar) të hulumtimit dhe prezentimit.



## NORMATIVI I KUADRIT MËSIMOR:

### a) Arti muzikor (kultura muzikore)

1. Studime të kryera nga arti muzikor - sektori për teori dhe pedagogji muzikore, VII - 1;
2. Studime të kryera nga arti muzikor - sektore tjera dhe ka marrë përgatitje pedagogjike, psikologjike dhe metodike në Fakultetin e artit muzikor, VII - 1;

## ROLI I ARSIMITARIT

- njohja me nxënësit, zbulimi i motivit për përcaktimin e nxënësit për këtë lëmi;
- përpilimi i planifikimit të aktiviteteve si arsimtar-mentor;
- përcaktimi i ditëve dhe orët të cilat nuk do të përputhen me mësimin e rregullt, por nuk do t'i ngarkojnë plotësisht nxënësit;
- formimi i grupeve;
- audicioni për interpretues vokal;
- audicioni për përbërje instrumentale;
- formon grupe instrumentale dhe propozon program për plotësim;
- definim i qartë i çdo detyre (cila detyrë) dhe bartësit (cili nxënës), afatet (prej kur) dhe bashkëpunimi (me kë);
- këshilla nxënësit (ekipit) gjatë zgjedhjes së detyrës konkrete projektuese;
- ndihmë dhe orientim i nxënësve gjatë punës;
- këshilla nxënësit dhe dhënia e instruksioneve gjatë vizitës në institucionet e filharmonisë, operës, baletit dhe institucioneve tjera;
- roli i trajnuesit (trajnim i nxënësve për aktivitete konkrete);
- evidenca e aktiviteteve të nxënësve në ditarin e paraleles dhe kontrollimi i portfolieve të nxënësve;

## AKTIVITETET E NXËNËSIT

- të zgjedh të paktën një lëmi projektuese (temë) sipas mundësive dhe afiniteteve individuale;
- në mënyrë aktive dhe rregullisht të merr pjesë në të gjitha aktivitetet e paralajmëruara;
- të hulumton, analizon, zbulojë njohuri të reja për lëmi të caktuara
- të angazhohet që detyrën e vet me kohë dhe saktë ta realizojë;
- rregullisht t'i shënojë aktivitetet në portfolion e tij;
- të vendosë dhe të mbajë bashkëpunim të reciprok në ekip;
- të kenë marrëdhënie konkrete dhe respekt me institucionet me të cilat do të bashkëpunojë;
- t'i dëgjojë, përcjellë dhe shënojë kahjet të dhëna nga ana e arsimtarit;
- të jetë i aftë për interpretim vokal ose instrumental;
- të jetë aktiv dhe vizitues përgjegjës i operës, baletit dhe manifestimeve tjera që do t'i vizitojë;

- ta prezentojë detyrën e tij të kryer projektuese;

## BASHKËPUNIMI

- me nxënësit tjerë në grup, paralele dhe paralele tjera;

-të ketë bashkëpunim me arsimtar lëndor dhe arsimtarë tjerë;

- me bashkëpunëtorë tjerë profesional nga institucione tjera;

## KLUBI MUZIKORO-GAZETARESK

### QËLLIMI KRYESOR

Të zhvillojë dashuri dhe interes në lloje të ndryshme të muzikës përmes hulumtimit, analizimit, zbulimit të njohurive të reja dhe të arriturave në botën e muzikës. Nxitja e nxënësve për punë dhe bashkëpunim individual dhe ekipor në ekipin dhe gjetja e mundësive tjera për bashkëpunim jashtë shkollës (takime me emra të njohur nga sfera e muzikës).

- trajnim i nxënësit për përpilimin e projektit muzikor- tekst gazetaresk;

- mësimi dhe thellimi i njohurive nga lëmi i muzikës (lloje të ndryshme të muzikës) sipas dëshirës së ekipit hulumtues;

- bashkëpunim kreativ me individë dhe institucione të ndryshme që mundësojnë informim më të madh për hulumtimin në sferën e muzikës;

- shtëpi gazetareske, shtëpi produktive, FAD, SHKA, TPM dhe emra eminent nga bota e muzikës)

- aftësimi i nxënësve për evidentim, selektim, analizë, të informatave- selektimgazetaro-botuese;

- aftësimi i nxënësve për prezentim individual të detyrës së kryer;

- përkrahje e shkollës për plotësimin e projektit që duhet të realizohet në korelacionin me gazetën e shkollës;

- dhënia e informatave muzikore përmes prezentimit të ngjarjes më të re, lajme, si dhe një numër të madh të informacioneve për atë që shpirtërisht i kënaq nxënësit- muzika;

|    | LËMI               | TEMA  |
|----|--------------------|---|
| 1. | HISTORIA E MUZIKËS | <p>karakteristika të renesansës muzikore, përfaqësues më të rëndësishëm dhe forma muzikore të kësaj periudhe</p> <p>Paraqitja e operës dhe zhvillimi i saj</p> <p>Instrumentizmi në periudhën e barokut muzikor</p> <p>Simfonia në periudhën e klasicizmit muzikor dhe "Klasikët e Vienës"</p> <p>Përfaqësues eminent të romantizmit</p> <p>Paraqitja dhe zhvillimi i stileve bashkëkohore në muzikë (xhez, rok, pop, rap, teho etj)</p> <p>Vizita e manifestimeve muzikore (operë, filharmoni, koncerte nga lëmi i muzikës bashkëkohore), kontakte dhe intervista me kompozitorë, dirigjentë etj.</p> <p>Vizitë në FAD dhe realizimi i kontakteve me disa kompozitorë shqiptarë, dirigjentë etj</p> <p>Vizitë TV dhe radio stacionet</p> |
| 2. | FOLKLORI           | <p>Ruajtja e traditës folklorike në pjesë të ndryshme të Maqedonisë</p> <p>Vizita dhe kontakte me SHKA</p> <p>Vizita në Institutet e folklorit</p> <p>Portrete në SHKA</p> <p>Kontakte dhe intervista me emra të njohur nga lëmi i muzikës popullore.</p> <p>Vizita në festivale të muzikës popullore (realizim kontaktesh dhe intervista me interpretatorë të njohur);</p>   |
| 3. | TALENTË TË RINJË   | <p>Kontakte me nxënës dhe studentë nga MBUC dhe FAD</p> <p>Kontakte me nxënës dhe shkolla tjera muzikore.</p> <p>Kontakte dhe vizita në festivale muzikore të fëmijëve</p>  |

|    |             |  |
|----|-------------|--|
| 4. | KURIOZITETE | Top lista e muzikës serioze<br>Top lista e muzikës argëtuese |
|    |             | Top lista shqiptare  |
|    |             | Horoskopi muzikor  |
|    |             | Enigma muzikore  |

## ORGANIZIMI I KOHËS

Arsimtari organizon dhe realizon udhëheqje të më shumë projekteve nga tema e njëjtë në të cilën janë inkuadruar grupe punuese, nxënës të moshës së njëjtë (viti i parë ose i dytë, viti i tretë dhe i katërt).

Vizita në koncerte, opera, balet dhe manifestime tjera muzikore organizohen sipas ngjarjes së planifikuar dhe organizuar ose stacioni i paraparë në institucion të caktuar. Vizitat do të jenë individuale ose në grupe, dhe më pas e prezentojnë aktivitetin e tyre para arsimtarit dhe sëbashku e planifikojnë kohën për konsultime dhe rrëfime të problemeve të dhëna, si dhe të sistematizimit të informacioneve të marura dhe bashkarisht marrin pjesë në përpilimin e gazetës. Çdo nxënës duhet të përgatitë tregim (në formë të shkruar) në hulumtimin dhe prezentimin e tij.

## NORMATIVI PËR KUADRIN MËSIMOR:

b) Arti muzikor (kultura muzikore)

3. Studime të kryera të artit muzikor- pjesa për teori muzikore dhe pedagogji, VII -1;
4. Studime të kryera të artit muzikor- pjesë tjera dhe kanë fituar përgatitje pedagogjike, psikologjike dhe metodike në fakultetin e artit muzikor, VII -1;

## ROLI I ARSIMTARIT

- njohja me nxënësit, zbulimi i motivit për përcaktimin e nxënësit për këtë lëmi;
- përpilimi i planifikimit të aktiviteteve si arsimtar-mentor;
- përcaktimi i ditëve dhe orës që nuk do të përputhet me mësimin e rregullt, por plotësisht nuk do t'i ngarkojë nxënësit;
- formimi në grupe;
- definimi i qartë i çdo detyre (cila detyrë), bartësit (cili nxënës), afatet (deri kur), bashkëpunimi (me cilin);
- formimi i anëtarëve të redaksisë dhe këshilldhënësve;
- këshillimi i nxënësve gjatë zgjedhjes të lëmisë -temës konkrete projektuese;
- ndihmë dhe orientime të nxënësve gjatë punës;
- këshillë nxënësit dhe dhënia e instruksioneve gjatë vizitës të institucioneve të caktuara, redaksive muzikore, radio dhe TV stacioneve etj.
- roli i trajnuesit (trajnimi i nxënësve për aktivitete konkrete);
- evidenca nga aktivitetet e nxënësve në ditar të paraleles dhe kontrollimi i portfolios së nxënësit.

## AKTIVITETET E NXËNËSIT

- të zgjedh së paku një lëmi projektuese sipas afiniteteve dhe mundësive individuale;
- të merr pjesë aktive dhe rregullisht në të gjitha aktivitetet e paralajmëruara;
- të hulumtojë dhe zbulojë njohuri të reja për lëmi të caktuar;
- të angazhohet që detyra e tij me kohë dhe saktë të realizohet;
- rregullisht t'i shënojë aktivitetet në portfolion e tij;
- të vendosë dhe të mbajë bashkëpunim reciprok me ekipin;
- të kenë marrëdhënie konkrete dhe respekt me institucionet dhe personat me të cilat do të bashkëpunojnë;

## BASHKPUNIMI

- me nxënësit tjerë të grupit, paraleles dhe paraleleve tjera;
- të ketë bashkëpunim me arsimtarë lëndor dhe arsimtarë tjerë;
- me seksionin gazetaresk në shkollë;
- me bashkëpunëtorë tjerë profesional;

## KLUBI FOLKLORIK

### Qëllimi i përgjithshëm

Të zhvillojë dashuri dhe interes drejtë folklorit të pasur përmes hulumtimeve të ndryshme, analizave, zbulimeve të njohurive të reja dhe të arriturat në lëmin e krijimtarisë folklorike. Nxitja e nxënësve për bashkëpunim individual dhe grupor, organizimi i aktiviteteve projektuese në kuadër të shkollës ( formimi i grupit të valltarëve , bashkangjitja e materialeve vizuale dhe auditive të këngëve të ndryshme popullore burimore dhe valleve) si dhe gjetja e mundësive tjera për bashkëpunim jashtë shkollës ( vizitë dhe SHKA, instituti i folklorit, koncerte të ndryshme të valleve popullore , muzikës popullore dhe intervistë me këngëtarë të këngëve burimore dhe të atyre të posa krijuara).

### Qëllimet konkrete

- trajnimi i nxënësit për përpilimin e projektit nga lëmi i krijimtarisë folklorike;
- zbulimi i aftësisë për interpretim vokalo-individual të këngëve burimore shqiptare;
- zbulimi i aftësive për paraqitje grupore të valleve dhe lojrave tradicionale shqiptare;
- zgjerimi dhe thellimi i njohurive të nxënësit nga krijimtaria e lëmisë folklorike ( vizitë e organizuar në koncert të instrumenteve popullore burimore etj );
- bashkëpunim me institucione të ndryshme që mundësojnë informim më të gjerë për hulumtim në fushën e folklorit popullor (instituti i folklorit, SHKA etj),
- aftësimi i nxënësve për analizimin e instrumenteve popullore;
- vizitë në festivalin folklorik;
- aftësimi i nxënësve për prezentimin e detyrës së kryer e cila bazohet në bazë të të informatave të reja të marrura nga bisedat me persona profesional nga lëmi i krijimtarisë popullore si dhe nga vizitat e koncerteve të ndryshme dhe SHKA;
- përkrahje e plotë nga shkolla për prezentimin e projektit.

|    | LËMI               | TEMA  |
|----|--------------------|---|
|    | KËNGË<br>POPULLORE | Llojet e këngëve popullore (dasmave, riteve, dashurisë etj)   |
|    |                    | Analiza e këngëve popullore burimore  |
|    |                    | Interpretimi vokal (krijimi i grupit të këngëtarëve në shkollë)   |
|    |                    | Ritmi i këngës popullore  |
|    |                    | Karakteristikat e këngëve të gurbetit   |
|    |                    | Analiza e këngës së re popullore  |
|    |                    | Rëndësia e këngëve popullore për kulturën tonë të kaluar  |
|    |                    | Ineresimi i të rinjve sot për ruajtjen e traditës së këngëve popullore  |
|    |                    | Llojet e instrumenteve popullore (prej teli,*****)  |
|    |                    | Vizitë ndërtuesve të instrumenteve popullore dhe bisedë me të njëjtit për mënyrën e ndërtimit të instrumenteve  |
|    |                    | Organizim për të dëgjuar fragmente me instrumente popullore dhe paranoftim me të njëjtit                        |
|    |                    | Analizë në detaje të disa llojeve të instrumenteve  |
|    |                    | Fragmente nga instrumentet prej teli (Rapsodi shqiptar ) nga *****<br>Baladë për violonçelon nga V. Nikollovski |
|    |                    | Intervistë me interpretatorë të instrumenteve popullore   |
|    |                    | Organizim për të vizituar koncerte të instrumenteve popullore burimore dhe analizë të njëjtave                  |
| 3. | VALLE<br>POPULLORE | Vallja- traditë popullore   |
|    |                    | Valle popullore të femrave dhe analizë  |
|    |                    | Valle popullore të meshkujve  |
|    |                    | Formimi i shoqatës së valltarëve në kuadër të shkollës  |
|    |                    | Paraqitje praktike të valleve sipas dëshirës së nxënësve  |
|    |                    | Bashkangjitja e materialeve vizuele dhe auditive nga sfera e valleve popullore                                  |
|    |                    | Vizitë për ushtrime në SHKA "Emin Duraku" dhe analiza e ushtrimeve  |
|    |                    | Vizita në koncerte të valleve popullore (Valle pa kufi ) dhe analiza e koncertit                                |
| 4. | Veshjet popullore  | Veshja popullore-reprezentim më i shprehur në   |



|    |                   |   |
|----|-------------------|---|
|    |                   | bujshmërinë tradicionale të popullit shqiptar   |
|    |                   | Karakteristikat e veshjeve popullore (bujshmëria në ngjyra, detaje dhe stoli të llojllojshme)                             |
|    |                   | Specifikat e veshjes shqiptare  |
|    |                   | Llojet e veshjeve popullore (festa dhe solemnitete)   |
|    |                   | Bashkangjitja e veshjeve të vendeve të ndryshme në R. e Maqedonisë dhe dallimi midis tyre                                 |
|    |                   | Punimet e dorës, qendisja popullore - tiparet e veshjeve popullore  |
|    |                   | organizimi i vizitës në SHKA "Emin Duraku" dhe njohja për së afërmi me veshjet dhe materialet                             |
| 5. | PËRPUNIMI NË PANO | Grumbullimi i materialeve nga sfera e këngëve popullore, instrumenteve, valleve dhe veshjeve dhe ekspozimi i tyre në pano |
|    |                   | Të treguarit e këngëve popullore shqiptare më të mira në pano sipas dëshirës së nxënësve                                  |
|    |                   | Ilustrimi i punës së dorës (qendisjes) tradicionale shqiptare   |
|    |                   | Vizatime të llojeve të ndryshme si të qilimave dhe mbulesave në të cilat vërehet qendisja popullore                       |



## ORGANIZIMI I KOHËS

Arsimtari i organizon grupet dhe "paralelisht" e udhëheq dhe e realizon projektin nga e njejta lëmi në të cilin punojnë grupë nxënësish të moshës dhe vitit së njejtë (viti i I, viti i II) Lëmia e cila duhet realizuar, kurse lidhur me institucionin (muzej, SHKA, instituti i folklorit etj) Duhet realizuar sipas planit dhe në marrëveshje me institucionin përkatës. Gjatë vizitës së këtyre institucioneve për realizimin e aktiviteteve mund të inkuadrohen nxënës të të gjitha viteve që kanë treguar interesim. Arsimtari e planifikon kohën për konsultime dhe iu tregon për literaturën e ruajtur në të kaluarën etj burime materiale, i korrigjon dhe tregon në interpretimin vokal dhe instrumental. Çdo nxënës duhet të përgatitë mendim në formë të shkruar dhe ta prezantojë, kurse për kohën dhe vendin e prezantimit bëjnë marrëveshje arsimtari dhe nxënësi.

### NORMATIVI PËR KUADRIN MËSIMOR:

#### e) Arti muzikor (kultura muzikore)

5. Studime të kryera nga arti muzikor - pjesa për teori muzikore dhe pedagogji, VII-1;
6. Studime të kryera nga arti muzikor - pjesë tjera dhe ka fituar përgatitje nga pedagogjia, psikologjia dhe metodika në Fakultetin e artit muzikor, VII-1;

### ROLI I ARSIMITARIT

- njihja me nxënësit, zbulimi i motiveve për përcaktimin e nxënësit në këtë lëmi.
- Përpilimi dhe planifikimi i aktiviteteve si arsimtar-mentor.
- Formimi i grupeve.
- Radhitja e ditëve dhe orëve që nuk do të përputhet me mësimin e rregullt por jo plotësisht nuk do t'i ngarkojë nxënësit.
- Audicioni të interpretatorëve vokal, dhe solistëve instrumental.
- Të bashkëpunojë dhe kontaktojë me interpretues vokalo-instrumental.
- Të kontaktojë, bashkëpunojë dhe të bëjnë marrëveshjen e termineve me institucionet që duhet t'i vizitojnë.
- Këshë nxënësit (ekipit) gjatë zgjedhjes të detyrës konkrete projektuese.
- Qartë e definon detyrën që duhet ta plotësojë nxënësi, e cakton afatin (deri kur) dhe bashkëpunimin (me cilin).
- Ndhmon gjatë punës
- I këshillon nxënësit dhe iu jep instruksione gjatë vizitës në institucionet SHKA, koncerte, muzej etj
- Përgatitja e nxënësve për prezentim të detyrës së kryer.
- Evidentimi i aktiviteteve të nxënësve në ditarin e paraleles dhe kontrollimi i portfoliove të nxënësve.

### Aktivitetet e nxënësit

- Të zgjedh së paku një lëmi projektuese sipas afiniteteve dhe mundësive individuale.
- Të jetë i rregullt, aktiv dhe i ndërgjegjshëm për të gjitha takimet e paralajmëruara.
- Të tregojë nivel të lartë të kulturës, bashkëpunimit me individë, grupe ose institucione.
- Të hulumtojë, analizojë dhe liron njohuri të reja për lëmin e caktuar.
- Të angazhohet dhe ta plotësojë detyrën e parashtruar me kohë

- Rregullisht t'i shënojë aktivitetet në portfolion e tij.
- T'i dëgjojë, përcjellë dhe shënojë drejtimet e dhana nga ana e arsimtarit.
- T'i përcjellë, vërejë, çmojë vlerat folklorike dhe manifestimet.
- Të talentuarit mund të të mund në mënyrë teknike dhe melodike të zbatojnë interpretim vokal ose instrumental.

## Bashkëpunimi

- \* Të bashkëpunohet me nxënësit në grupe, paralele dhe paralele tjera.
- \* Të bashkëpunohet me individë, grupe dhe institucione të ndryshme si dhe bashkëpunëtorë profesional.

## KOMPOZITORË TË RINJË- HULUMTUES

### Qëllimi i përgjithshëm

Të zhvillojë dashuri dhe interes të llojeve të ndryshme të muzikës përmes hulumtimit, analizës, zbulimi i njohurive të reja dhe të arriturat në lëmin e muzikës. Nxitja e nxënësve për kreativitet individual dhe bashkëpunim me organizata të ndryshme që do t'iu mundësojnë dhe ndihmojnë për t'iu treguar aftësitë e tyre krijuese muzikore. Gjithashtu, është e mundur edhe aktivitet grupor në kuadër të shkollës ( formimi i laboratorisë muzikore, ku përmes dëgjimit të materialeve të ndryshme auditive dhe vizuale, nxënësit do të mund ta zbulojnë mënyrën e krijimit-komponimit). Bashkëpunimi do të jetë edhe me FAM ( ku kemi pjesë për komponim), me kompozitorë për të gjitha llojet e muzikës.

### Qëllimet konkrete

- trajnimi i nxënësit për përpilimin e projekteve muzikore;
- zgjerimi dhe thellimi i njohurive nga lëmi i muzikës (lloje të ndryshme të muzikës);
- zbulimi i aftësive krijuese për komponim;
- aftësimi i nxënësve për analizën e partiturave nga kompozitorët e huaj dhe të vendit;
- vizita dhe biseda me kompozitorë- krijues të llojeve të ndryshme të muzikës;
- vizitë e organizuar në koncerte ose lloje tjera të manifestimeve;
- bashkëpunim kreativ me institucione të ndryshme që mundësojnë informatë më të gjërë për hulumtim në sferën e muzikës (Fakulteti i artit muzikor - pjesa e komponimeve);
- aftësimi i nxënësve për prezentimin e detyrës së kryer;
- përkrahje e plotë nga shkolla për prezentimin e projektit.

|    | LËMI               | TEMA  |
|----|--------------------|---|
| 1. | HISTORIA E MUZIKËS |   |
|    |                    | Minijaturë e klavirit (mënyra e krijimit)                   |
|    |                    | Karakteristikat për krijimin e muzikës së barokut           |
|    |                    | Analiza e tekstit të solo këngëve "Trofta" nga F. Schubert. |
|    |                    | Notacioni bashkëkohor                                       |
|    |                    |   |
|    |                    |   |
|    |                    |   |
| 2. | MUZIKA POPULLORE   | Kompozitorët e parë shqiptarë të muzikës popullore          |
|    |                    | Mënyra e krijimit të këngës së vjetër popullore shqipe      |
|    |                    | Valle tradicionale;...                                      |
|    |                    | Ndikimi i kulturave tjera në këngën tonë popullore          |
|    |                    |   |
|    |                    |   |
| 3. | MUZIKA ARGËTUESE   | Muzika elektronike  |
|    |                    | Krijimtaria e .....   |
|    |                    | Kitaristët në Maqedoni                                      |
|    |                    | Hip-hop muzika  |
|    |                    | Pop- muzika   |
|    |                    |   |

## Organizimi i kohës

Arsimtari i organizon nxënësit dhe i kahëzon drejtë qëllimeve të parashtruara nga kjo lëmi. Në këtë lëmi mund të punohet individualisht por edhe në grupe (punë ekipore). Lëmi e cila duhet të realizohet është e lidhur edhe me institucionet (FAM, TVM ) e cila duhet të vizitohet për konsultime ose për grumbullimin e materialeve, dhe për këtë duhet të realizohet në marrëveshje me institucionin përkatës. Gjatë vizitës së këtij lloji të institucionit për realizimin e aktiviteteve mund të inkuadrohen nxënës nga të gjitha vitet që kanë treguar interesim. Arsimtari e planifikon kohën e konsultimeve dhe sqaron për literaturën e ruajtur etj., burime të materialeve, e korrigjon dhe e orienton nxënësin për qëllimin e parashtruar të lëmisë. Çdo nxënës duhet të përgatit tregim në formë të shkruar dhe ta prezentojë, ndërsa për kohën dhe orën e prezentimit bëjnë marrëveshje nxënësi dhe arsimtari.

## NORMATIVI PËR KUADRIN MËSIMOR:

### d) Arti muzikor (kultura muzikore)

7. Studime të kryera nga arti muzikor - pjesa për teori muzikore dhe pedagogji, VII-1
8. Studime të kryera nga arti muzikor - pjesë tjera dhe ka fituar përgatitje pedagogjike, psikologjike dhe metodike në Fakultetin e artit muzikor, VII-1;

### Roli i arsimtarit

- njohja me nxënësit, zbulimi i motiveve për përcaktimin e nxënësve për këtë lëmi;
- përpilimi dhe planifikimi i aktiviteteve si arsimtar-mentor;
- formimi i grupeve;
- caktimi i ditëve dhe orës që nuk do të përputhet me mësimin e rregullt por plotësisht nuk do t'i ngarkojë nxënësit;
- të kontaktojë, bashkëpunojë dhe cakton termine me institucionet që duhet të vizitohen;
- këshillë nxënësit (ekipit) gjatë zgjedhjes së detyrës konkrete projektuese;
- qartë e definojnë detyrën që duhet ta plotësojë nxënësi, e cakton afatin (deri kur) dhe bashkëpunimin (me cilin).
- ndihmon gjatë punës dhe i orienton.
- i këshillon nxënësit dhe iu jep instruksione gjatë vizitës së institucioneve FAM, koncerteve etj.
- përgatitja e nxënësve për prezentimin e detyrës së kryer.
- ta inçizojë (merr) shënimin nga nxënësi ose grupi.
- t'i evidentojë aktivitetet e nxënësve në ditarin e paraleles dhe kontrollim i portfoliove të nxënësve.

### Aktivitetet e nxënësve

- të zgjedhë së paku një lëmi projektuese sipas afiniteteve dhe mundësive të veta;

- të jetë i rregullt, aktiv dhe i aftë për të gjitha aktivitetet e paralajmëruara;
- të trgojë nivel të lartë të kulturës në bashkëpunim me individët, grupet, institucionet etj;
- të hulumtojë, analizojë dhe të përfitojë njohuri të reja për lëminë e caktuar;
- të angazhohet dhe ta plotësojë detyrën e parashtruar me kohë;
- rregullisht t'i shënojë aktivitetet në portfolion e vet;
- t'i dëgjojë, përcjellë dhe vërejë kahjet e dhëna nga ana e arsimtarit;
- t'i përcjellë, vërejë vlerat muzikore;
- të mundë teknikisht ta prezentojë projektin e vet ;

### **Bashkëpunimi**

- të bashkëpunohet me nxënësit në grup, paralele dhe paralele tjera;
- të bashkëpunojë me arsimtarin lëndor dhe me arsimtarët tjerë;
- të bashkëpunojë me individë, grupe dhe institucione të ndryshme, si dhe me bashkëpunëtorë profesional.

Këshilltare e artit muzikor  
Ankica Vitanova